



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 4730/prot.
1

Tiranë, më 26.08.2025

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. Nr.810/1, datë 04.10.2004.

SHOQËRISË “ELJO-COMPANY 2003” SH.P.K

Rr. “Formula e Pagëzimit”, Pallati Nr.5, Kati i 5, Burrel, Dibër

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “ELJO-COMPANY 2003” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.810/1, datë 04.10.2004, për mineralin krom, Objekti “Maja e Lugut Veriperëndimor”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 2643 prot., datë 01.07.2025, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 4730 Prot., datë 03.07.2025, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.810/1, datë 04.10.2004, për mineralin krom, Objekti “Maja e Lugut Veriperëndimor”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, pasi afati i vlefshmërisë së kësaj leje ka mbaruar më datë 04.10.2024.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 16, pika 1, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.810/1, datë 04.10.2004, për mineralin krom, Objekti “Maja e Lugut Veriperëndimor”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.810/1, datë 04.10.2004, për mineralin krom, Objekti “Maja e Lugut Veriperëndimor”, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të

përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

DHE

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME URDHËR PËR DELEGIM

ZËVENDËSMINISTRI

AM KOSI

